



## DEKLARATË PRELIMINARE

### Proces zgjedhor i qetë dhe dinamik përkundër retorikës së ashpër që reflekton ndarje të thella

Prishtinë, Kosovë, 11 shkurt 2025

*Kjo deklaratë preliminare e misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve nga BE (EU EOM) jepet para përfundimit të të gjithë procesit zgjedhor. Fazat kritike mbeten, përfshirë numërimin e votave, tabelimin e rezultateve dhe gjykimin e ankesave. EU EOM tani është në gjendje të komentojë vetëm për vëzhgimet e bëra deri më tani, dhe më vonë do të publikojë një raport përfundimtar, duke përfshirë analizën e plotë dhe rekomandimet për forcimin e proceseve zgjedhore. EU EOM gjithashtu mund të bëjë deklaratat shtesë për çështje që kanë të bëjnë me zgjedhjet, nëse dhe kur e konsideron të përshtatshme.*

#### Përmbledhje

Zgjedhjet ishin të qeta dhe konkurruese me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve, duke testuar një kornizë të re ligjore. Fushata ishte dinamike përkundër retorikës së ashpër që pasqyrore ndarjet e thella politike. Dita e zgjedhjeve u menaxhua mirë falë përpjekjes kolegjiale të stafit të vendvotimeve, duke kapërcyer sfidat e shkaktuara nga vendimet e vonuara të KQZ-së. Përkundër vonesave në tabelimin e rezultateve, procesi i përgjithshëm demonstroi qëndrueshmëri dhe përkushtim ndaj parimeve demokratike.

Zgjedhjet parlamentare 2025 ishin të parat që u mbajtën në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të miratuar në vitin 2023, i cili solli disa risi që synojnë rritjen e besimit të palëve të interesuara dhe rritjen e transparencës së procesit zgjedhor. Korniza ligjore ofron bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Zbatimi i kornizës së re ligjore për zgjedhjet ka nxjerrë në pah se disa aspekte të ligjit kërkojnë sqarime të mëtejshme për të shmangur mundësinë për paqartësi.

Megjithëse administrata e zgjedhjeve në përgjithësi gëzon besimin e palëve të interesuara, u ngritën disa shqetësime mbi paanshmërinë dhe pavarësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga ndikimi politik. Në procesin zgjedhor u panë përpjekje për politizimin e institucioneve kyçe nga partia në pushtet, veçanërisht KQZ-në dhe Komisionin e Pavarur të Mediave. KQZ-ja u përfshi në mosmarrëveshje politike dhe politizoi disa aspekte teknike të procesit zgjedhor. Përpjekja e anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga *Lëvizja Vetëvendosje* (LVV) për të parandaluar certifikimin e *Listës Serbe* (LS), dhe bllokimi i shpërndarjes së fondeve publike për partitë politike vunë presion të konsiderueshëm mbi institucionin.

Lista votuese përfundimtare përmbante gjithsej 2,075,868 votues, përfshirë 104,924 të regjistruar për votim jashtë Kosovës. Ndonëse bashkëbiseduesit e EU EOM-së shprehën besim në aspektin gjithëpërfshirës të listës votuese, ende vazhdon të ketë shqetësime për saktësinë e saj, kryesisht për shkak të mangësive në regjistrimin civil. KQZ certifikoi 28 subjekte politike me 1,279 garues. Përqindja e kandidatëve [gra] përbënte vetëm një rritje të papërfillshme krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2021. Procesi i certifikimit ishte përgjithësisht gjithëpërfshirës, megjithatë u njollos nga mosmarrëveshja e ndikuar politikisht brenda KQZ-së. KQZ pati vonesa të konsiderueshme në aspekte të caktuara të përgatitjeve teknike dhe administrative dhe disa vendime i miratoi me vonesë, përfshirë udhëzimet teknike dhe emërimin e organeve zgjedhore të nivelit më

\*Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin ndaj statusit dhe është në përputhje me RKS KB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

*Kjo deklaratë preliminare është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, por vetëm versioni anglisht është zyrtar.*

të ulët. Kjo pati ndikim negativ në efikasitetin dhe kohën e duhur të përgatitjeve. Disa parti u treguan kritike ndaj përbërjes së këshillave të vendotimeve për mungesë të përfaqësimit të mjaftueshëm.

Në anën pozitive, fushata ishte dinamike pa incidente të mëdha. Megjithatë, retorika negative, sulmet e ashpra verbale dhe gjuha nxitëse ishin mjaft të përhapura gjatë ngjarjeve të fushatës. Gratë kandidatë iu nënshtruan sulmeve verbale seksiste, kishin më pak mjete se homologët e tyre meshkuj dhe tërhoqën më pak mbulueshmëri mediatike. Nuk u zhvilluan debate kuptimplota ndërmjet kandidatëve kryesorë. Një numër i madh i rasteve janë paraqitur në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, duke rezultuar në shqiptim të gjobave të larta për shkelje të kodit të mirësjelljes. Vëzhguesit dhe bashkëbiseduesit e EU EOM-së raportuan për keqpërdorim të resurseve publike nga shumë subjekte politike dhe në disa raste ato u sanksionuan.

Në komunat e Kosovës me shumicë serbe pati një fushatë relativisht të përmbajtur. LS mbeti dominuese brenda komunitetit serb të Kosovës, duke marrë përkrahjen e Presidentit të Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe duke u mbështetur në mediat e Serbisë dhe mediat e vogla serbe të Kosovës. Përveç kësaj, u raportua për ushtrim presioni ndaj votuesve që vareshin nga asistenca sociale dhe punësimi i Serbisë. Megjithatë, pjesëmarrja e gjashtë partive politike serbe të Kosovës u perceptua si një hap pozitiv drejt rritjes së pluralizmit politik.

Subjektet politike nga komunitetet e vogla joshumicë u përballën me sfida në financimin e fushatës, dhe për disa, qasja e kufizuar në media krijoi kushte të pabarabarta. Në vend të kësaj, subjektet politike joshumicë zhvilluan shumicën e aktiviteteve të tyre të fushatës brenda komuniteteve të tyre.

Fushata online ishte shumë e spikatur, duke pasqyruar tonin agresiv të debateve dhe tubimeve publike. Të gjitha partitë politike që garojnë në zgjedhje dhe mbi gjysma e kandidatëve zhvilluan fushatë në mediat sociale, kryesisht në Facebook dhe Instagram. Toni i ashpër i fushatës u pasqyrua edhe në mediat sociale përmes videove të ngjarjeve të fushatës, të cilat përbënin një pjesë të madhe të përmbajtjes së postuar nga partitë dhe kandidatët.

Liria e shprehjes dhe liria e mediave janë të garantuara me kornizën ligjore, dhe në përgjithësi respektohen. Megjithatë, Komisioni i Pavarur i Mediave humbi kuorumin e tij tri javë para ditës së zgjedhjeve, duke dështuar kështu të sanksionojë shkeljet e shumta mediatike gjatë fushatës. Transmetuesi publik RTK1 ofroi mbulim të barabartë në lajme për garuesit kryesorë. Pavarësisht financimit të dobët, RTK2, transmetuesi publik në gjuhët e komuniteteve joshumicë, organizoi debate, por shikueshmëria e tij e kufizuar dhe refuzimi i LS-së që të marrë pjesë i lanë partitë e tjera të serbëve të Kosovës me mundësi minimale për fushatë përtej mediave sociale. LVV bojkotoi tri mediat më të njohura private, duke përmendur njëanshmërinë.

---

*Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimit Evropian (EU EOM) ka qenë i pranishëm në Kosovë që nga 8 janari, pas ftesës nga presidentja e Kosovës. Misioni udhëhiqet nga Shefja e Misionit, Znj. Nathalie Loiseau, Anëtare e Parlamentit Evropian (Francë). Në total, EU EOM-i shpërndau 104 vëzhgues nga 27 shtete anëtare të BE-së, Kanadaja, Norvegjia dhe Zvicra, në tërë Kosovën, për të vlerësuar të gjithë procesin zgjedhor në raport me standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe ligjet e Kosovës. Një delegacion i Parlamenti Evropian, i kryesuar nga Marta Temido, deputete e PE-së, gjithashtu iu bashkua misionit dhe mbështet plotësisht këtë deklaratë. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan mbi 412 vendvotime në të 38 komunat e Kosovës për të vëzhguar votimin dhe numërimin.*

*Kjo deklaratë preliminare jepet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, veçanërisht nga numërimi dhe tabelimi i rezultateve dhe nga zgjidhja e parashtrësve dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. EU EOM mbetet në Kosovë për të vëzhguar zhvillimet pas zgjedhjeve dhe do të publikojë një raport*

*përfundimtar me rekomandime të hollësishme brenda dy muajsh pas përfundimit të procesit zgjedhor. EU EOM është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe i përmbahet Deklaratës së vitit 2005 mbi Parimet për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të miratuar në Kombet e Bashkuara.*

## Gjetjet Preliminare

### KONTEKSTI POLITIK

Kosova organizoi zgjedhjet 2025 pas përfundimit të një mandati të plotë qeveritar. Peizazhi politik në katër vitet e fundit është formësuar nga qeveria e *Lëvizjes Vetëvendosje* (LVV) dhe kryeministri Albin Kurti, ndërsa partitë kryesore politike në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK-NISMA) arritën të ruajnë pozitën e tyre të fortë në komuna pas zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Qeveria është kritikuar se ka kontribuar në polarizimin e peizazhit politik me partitë opozitare shqiptare të Kosovës dhe ka penguar procesin e normalizimit me komunitetin serb të Kosovës, i cili mbetet shumë i ndikuar nga Serbia. Afirmimi i sovranitetit të Kosovës ka qenë fokusi kryesor i politikave dhe iniciativave të partisë në pushtet. Sovraniteti po ashtu u shfaq si temë kryesore e fushatës së LVV-në, përmbledhur në sloganin e saj kryesor "Cep më cep". Përpjekja e udhëhequr nga LVV për të parandaluar certifikimin e *Listës Serbe* (LS) të lidhur me Serbinë u pasua nga një intensifikim i retorikës që synonte delegjitimimin e pjesëmarrjes së LS-së në zgjedhje, ku LVV e lidhte LS-në dhe Beogradin me sulmin terrorist në *Banjaskë* në shtator 2023. Më 15 janar, autoritetet e Kosovës ndërmoren një operacion në shkallë të gjerë për të shpërbërë strukturat e operuara nga Serbia në 24 lokacione në komunat në jug të lumit Ibër. Komuniteti ndërkombëtar shprehu keqardhje për këto veprime si të pafavorshme për procesin e normalizimit të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit.

Në procesin zgjedhor u pa një politizim i institucioneve kryesore nga partia në pushtet, veçanërisht KQZ-ja dhe Komisioni i Pavarur i Mediave. KQZ u ngatërrua në mosmarrëveshje politike dhe politizoi disa aspekte teknike të procesit zgjedhor. Përpjekja nga anëtarët e KQZ-së të emëruar nga LVV për të parandaluar certifikimin e LS-së, dhe bllokimi i shpërndarjes së fondeve publike për partitë politike, vuri presion të konsiderueshëm mbi KQZ-në.

Pjesëmarrja në zgjedhje e gjashtë partive politike serbe të Kosovës shihet si një zhvillim pozitiv, duke çuar në një perceptim të rritjes së pluralizmit politik në komunitet. Megjithatë, LS deri më tani ka dominuar peizazhin politik në komunitetin serb të Kosovës, me presidentin serb Aleksandar Vuçiq që e mbështeti LS-në dhe u bëri thirrje serbëve të Kosovës që të votojnë në numër sa më të madh për kandidatët e tyre.

### KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet parlamentare rregullohen kryesisht me Kushtetutën e vitit 2008 (e ndryshuar në vitin 2020) dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) i miratuar në korrik të vitit 2023, si dhe legjislacionin dytësor, përfshirë rregulloret e KQZ-së, të cilat i detajojnë dispozitat e LZP-së.<sup>1</sup> Korniza ligjore krijon një bazë të shëndoshë për mbajtje të zgjedhjeve demokratike, megjithatë hapa të mëtejshëm mund të sigurojnë përfshirje të plotë, transparencë dhe stabilitet ligjor.

<sup>1</sup> Përfshirë Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2010 (i ndryshuar së fundmi në 2022), Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (LMPDK), Ligjin për Gjuhët, ligjet lidhur me mediat dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 janë të parat që mbahen sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), që shihet si një moment historik i rëndësishëm dhe i cili përfshinë disa rekomandime të mëhershme të EU EOM-së për të harmonizuar më tej kornizën ligjore të zgjedhjeve me standardet ndërkombëtare. Këto përfshijnë rritjen e autonomisë financiare të KQZ-së, digjitalizimin e proceseve, krijimin e një autoriteti mbikëqyrës për financimin e fushatës, futjen e dispozitave për të siguruar pluralitetin mediatik dhe dispozita të detajuara për votim me asistencë. Më tej, ligji promovon përfshirje më të madhe gjinore duke ofruar stimuj financiarë për subjektet politike, deputetët e të cilëve përfshijnë më shumë se 30 përqind gra. Përtej kësaj, LZP modifikon sistemin zgjedhor duke rritur numrin e votave preferenciale nga pesë në dhjetë dhe ndryshon formulën për ndarjen e mandateve, aplikon dispozita për fushatën online dhe heq ato që mund të çojnë në tërheqjen arbitrare të akreditimit të vëzhguesve. Me gjithë këto përmirësime, ligji lë një fushëveprim të gjerë rregullator për legjislacionin dytësor, ndërkohë që disa dispozita do të mund të përfitonin nga qartësia dhe harmonizimi i mëtejshëm me tekste të tjera legjislative, veçanërisht në lidhje me rregullimin e mediave, barazinë gjinore dhe financimin e fushatës.

Të 120 deputetët e Kuvendit zgjidhen për një mandat katër vjeçar në një zonë të vetme zgjedhore me sistem të përfaqësimit proporcional me listë të hapur dhe votim preferencial për deri në dhjetë kandidatë. Njëqind mandate u ndahen partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë, me kusht që të kalojnë pragun prej pesë përqind të votave të vlefshme. Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet joshumicë, duke përfshirë dhjetë për komunitetin serb të Kosovës, tre për komunitetin boshnjak të Kosovës, dy për komunitetin turk të Kosovës dhe nga një për komunitetet goran, rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës, si dhe një ulëse për njërin prej tri komuniteteve të fundit që ka numrin më të madh të votave.

## **ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

Zgjedhjet menaxhohen nga KQZ, organ i përhershëm, 38 komisione komunale zgjedhore (KKZ) të themeluara përkohësisht dhe mbi 2,500 këshilla të vendvotimeve (KVV). Legjislacioni mundëson përfaqësim domethënës të subjekteve politike të kualifikuara në organet zgjedhore të nivelit më të ulët, pa ofruar kritere mjaftueshëm të qarta, duke i dhënë kështu KQZ-së diskrecion të gjerë në përcaktimin e formulës së emërimit. Shpërndarja fillestare nuk arriti të përmbushë plotësisht kriterin ligjor për të reflektuar rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare në nivelin komunal, në favor të disa subjekteve të reja që garojnë. Pas vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), KQZ-ja rishikoi shpërndarjen e pozitave në KVV dhe në ekipet e numërimit në 11 komuna, kryesisht për subjektet politike të komuniteteve joshumicë. Shumë bashkëbisedues nga parti të ndryshme politike shprehën pakënaqësi për ndarjen përfundimtare të pozitave. Kontestet për këto pozita kontribuan në vonesa të konsiderueshme në emërimin dhe trajnimin e KVV-ve dhe ekipeve të numërimit në mbarë Kosovën, gjë që u përkeqësua edhe më tej për shkak të vështirësive të disa subjekteve politike për të siguruar nominime të mjaftueshme për KVV-të.

Gjatë periudhës zgjedhore, KQZ ka mbajtur seanca të rregullta publike dhe përgjithësisht i ka publikuar vendimet e tyre me kohë. Megjithatë, disa seanca u reduktuan në vendime që merreshin vetëm me email dhe informacioni për disa çështje të diskutuara ishte i kufizuar vetëm në shënime të shkurtra në procesverbal, duke ulur kështu transparencën dhe llogaridhënien e KQZ-së. Për më tepër, disa udhëzime dhe vendime u miratuan relativisht vonë në proces, duke ndikuar në efikasitetin dhe kohën e përgatitjeve zgjedhore. Megjithëse administrata zgjedhore në përgjithësi gëzon besimin e palëve të interesuara, EU EOM ka vërejtur raste të ndikimit politik në procesin e vendimmarrjes së KQZ-së, përfshirë edhe për certifikimin e garuesve në zgjedhje dhe aprovimin e shpërndarjes së fondeve publike për partitë politike, duke rrezikuar pavarësinë dhe paanshmërinë e saj.

KQZ pati vonesa të konsiderueshme në disa aspekte të përgatitjeve teknike dhe administrative. Vështirësitë në procesin e prokurimit penguan seriozisht blerjen e pajisjeve teknike për qendrat e numërimit, përgatitjen e materialeve për edukimin e votuesve, si dhe operacionet logjistike për shpërndarjen dhe rikthimin e materialeve zgjedhore, përfshirë votat me postë për votimin jashtë Kosovës. KQZ po ashtu informoi EU EOM-në se kufizimet administrative për rekrutimin e personelit të përkohshëm zvogëluan mundësinë e komisionit për të siguruar nivelet e duhura të stafit, veçanërisht për monitoruesit e fushatës, trajnerët dhe ekspertët e TI-së.

Disa KKZ u shprehën të pakënaqura me komunikimin nga KQZ, duke përmendur njoftimet e vonuara dhe udhëzimet e pamjaftueshme, që shpesh rezultojnë në konfuzion për disa procedura. Disa KKZ po ashtu informuan EU EOM-në për mbështetjen e pamjaftueshme nga administratat komunale për sa i përket hapësirës për zyra, transportit dhe nevojave të tjera. Pavarësisht këtyre sfidave, vëzhguesit e EU EOM-së i vlerësuan KKZ-të si përgjithësisht efikase dhe transparente. Cilësia e sesioneve të trajnimit për stafin zgjedhor të vëzhguara nga EU EOM-ja ndryshonte në tërë Kosovën. Derisa shumica e seancave ishin informuese dhe interaktive, nganjëherë, temat kryesore si rregullorja e re për votimin me asistencë, rolet e anëtarëve të KVV-së dhe procedurat e numërimit nuk u trajtuan në mënyrë të njëjtë, duke çuar në zbatimin jokonsistent të tyre në ditën e zgjedhjeve.

Përkundër programit për edukim të votuesve të iniciuar nga KQZ para shpalljes zyrtare të zgjedhjeve, i cili përfshinte takime me pjesëmarrje fizike, materiale audio-vizuale në media dhe online, shumë bashkëbisedues të EU EOM-së i konsideruan këto përpjekje të pamjaftueshme dhe shprehën dyshime mbi efektivitetin dhe shtrirjen e fushatës së edukimit të votuesve. Sipas vëzhguesve të EU EOM-së, përfshirja e KKZ-ve në edukimin e votuesve mbeti e kufizuar, përkundër përgjegjësisë së tyre të re ligjore në këtë aspekt. Fushata për edukimin e votuesve mbuloi tema si regjistrimi i votuesve, përfshirë për votimin jashtë Kosovës, pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, luftimin e gjuhës diskriminuese në bazë gjinore, edukimin mediatik dhe procedurat e ditës së zgjedhjeve. Në aspektin pozitiv, KQZ-ja realizoi fushata informuese për votuesit në gjuhën e shenjave, siç kërkohet me ligj.

## **REGJISTRIMI I VOTUESVE**

Sistemi i regjistrimit të votuesve është pasiv dhe i centralizuar, me listën përfundimtare votuese të të gjithë votuesve me të drejtë vote të përpiluar nga KQZ-ja bazuar në të dhënat nga regjistri civil i menaxhuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) dhe bazën e të dhënave të Departamentit për Lëshimin e Dokumenteve të Identifikimit. Më 4 janar, KQZ certifikoi listën përfundimtare të votuesve me gjithsej 2,075,868 votues, një rritje prej 174,888 votuesish krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021.

Votuesit jashtë Kosovës duhej të regjistroheshin paraprakisht qoftë për votim me postë ose personalisht, i cili ka filluar të aplikohet për këto zgjedhje. Për votimin jashtë Kosovës, KQZ regjistroi gjithsej 104,924 votues: 20,416 votues për të votuar personalisht dhe 84,508 votues që zgjedhën votimin me postë. Pas regjistrimit, për shkak të numrit të vogël të votuesve në disa lokacione, si dhe për shkak të vështirësive logjistike dhe administrative, KQZ-ja vendosi të anulojë pesë qendra të planifikuara votimi jashtë vendit dhe i udhëzoi votuesit e prekur që të votojnë me postë. Votuesit me të drejtë vote të cilët nuk u regjistruan për votim jashtë Kosovës mbetën në listën votuese dhe kishin mundësi të votonin në vendvotimin e tyre të rregullt, ose në qendrën e caktuar për votim me kusht, të hapur në secilën komunë.

Lista votuese konsiderohet si gjithëpërfshirëse nga shumica e palëve të interesuara dhe të gjithë anëtarët e KQZ-së votuan njëzëri për të certifikuar listën votuese përfundimtare. Megjithatë, mbeten shqetësime për listën votuese që përmban votuesit e vdekur, kryesisht për shkak të pengesave administrative në sigurimin e provave zyrtare për heqjen e tyre nga lista, me sistemin aktual që bazohet kryesisht në deklarinimin e vdekjeve nga të afërmit dhe duke lejuar kompetenca të kufizuara të institucioneve publike në proces. Ndërsa LZP ofron mundësinë e kundërshtimit të regjistrimit të një votuesi nga një votues tjetër gjatë periudhës së shqyrtimit publik, në praktikë, votuesit kishin qasje vetëm në të dhënat e regjistrimit të tyre personal, duke kufizuar mundësitë për një shqyrtim kuptimplotë.

## **CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE**

Kandidatët për deputetë mund të caktohen nga partitë politike, koalicionet dhe iniciativat qytetare, ose mund të garojnë të pavarur. Të gjitha dokumentet e dorëzuara me aplikacionet për certifikim janë verifikuar nga Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (“Zyra”) e cila, pas disa korigjimeve nga dy parashtues, rekomandoi që të certifikohen të gjitha subjektet politike. Të gjitha listat e kandidatëve të dorëzuara me më shumë se dy kandidatë ishin në përputhje me kërkesën ligjore për një përfaqësim minimal gjinor prej të paktën 30 përqind të secilës gjini në listat e kandidatëve, me një kandidat të secilës gjini të përfshirë në çdo tre kandidatë.

Një proces përndryshe gjithëpërfshirës i certifikimit të garuesve në zgjedhje u njollos nga mosmarrëveshja e ndikuar politikisht e KQZ-së mbi certifikimin e kandidatëve të LS-së, që ishte rekomanduar nga Zyra. Ndonëse LZP-ja i jep Zyrës përgjegjësinë për certifikimin e garuesve në zgjedhje, me vendimin e KQZ-së i synuar të jetë si procedurë administrative për të konfirmuar certifikimin e atyre që përmbushnin kërkesat ligjore, dështimi i KQZ-së për të miratuar një vendim e bllokoi efektivisht procesin. Më 31 dhjetor 2024, PZAP udhëzoi KQZ-në që të certifikojë kandidatët e LS-së. Në total, KQZ certifikoi 28 subjekte politike dhe 1,279 garuesit e tyre që përfaqësonin 20 parti politike, pesë koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat të pavarur.

## **AMBIENTI I FUSHATËS**

Fushata zgjedhore zyrtare 30-ditore filloi më 11 janar dhe përfundoi në orën 07:00 në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e EU EOM i vlerësuan aktivitetet e fushatës në të cilat morën pjesë si të qeta, pa incidente të mëdha të sigurisë. Kandidatët raportuan se kishin lirinë e tubimit, shprehjes dhe lëvizjes gjatë gjithë fushatës. Subjektet kryesore politike shqiptare të Kosovës, përfshirë LVV-në, LDK-në, PDK-në, AAK-NISMA-n dhe Koalicionin për Familjen, bënë fushatë në mbarë Kosovën, dhe disa sporadike në veri. LVV, LDK dhe PDK organizuan shumicën e tubimeve të mëdha të fushatës. Aktivitetet derë më derë dhe takimet e vogla që synonin grupe të veçanta votuesish ishin metoda më e shpeshtë e fushatës e përdorur nga të gjithë garuesit. Temat kryesore të fushatës ishin zhvillimi ekonomik, arsimit, anëtarësimi në NATO dhe BE, reforma gjyqësore dhe mirëqenia sociale, me LVV që fokusohej në mënyrë të veçantë në sovranitetin e Kosovës. Për garuesit serbë të Kosovës, mesazhet kryesore të fushatës ishin siguria dhe mbrojtja e të drejtave të serbëve brenda Kosovës.

Ndonëse fushata zgjedhore ishte e gjallë pa incidente serioze të raportuara, ajo u karakterizua nga përdorimi i gjuhës negative dhe nxitëse dhe sulmeve të ashpra verbale ndaj kundërshtarëve, shpesh nga LVV, LDK, PDK dhe AAK-NISMA, në ngjarje publike, debate dhe online. Emisari i Shteteve të Bashkuara për misione speciale, Richard Grenell, u përfshi në fushatë duke kritikuar Kryeministrin Albin Kurti se nuk ishte partner i besueshëm për Shtetet e Bashkuara. Mesazhet e fushatës së Koalicionit për Familjen denigronin komunitetin LGBTIQ+ dhe promovonin rolet tradicionale gjinore në shoqëri, nganjëherë duke nxitur urrejtje. Në javët e fundit të fushatës u

intensifikuan retorika e ashpër dhe sulmet personale, duke çuar në ankesa të shumta në PZAP në lidhje me gjuhën e fushatës. Shumica e partive u angazhuan në fushata dinamike në internet, me Facebook-un si platformën kryesore, e ndjekur nga Instagram-i dhe TikTok-u. Fushata online reflektoi tonin e ashpër të tubimeve dhe debateve, ku videot e ngjarjeve të fushatës përbënin një pjesë të madhe të përmbajtjes së postuar.

Fushata në komunat e Kosovës me shumicë serbe ishte më e përmbajtur në krahasim me komunat e tjera. Katër nga gjashtë partitë serbe të Kosovës morën pjesë në tri debate të nxehta televizive, ku sulmet verbale dhe retorika nxitëse lanë në hije diskutimet përmbajtësore. Përveç kësaj, partitë më të vogla u përballën me sfida për të bërë fushatën për shkak të resurseve të kufizuara dhe gjobave të shqiptuara nga PZAP pasi LVV-ja dorëzoi ankesa të shumta për vendosjen jo të përshtatshme të materialit të fushatës. Fushata e LS ishte më e spikatura nga partitë serbe të Kosovës, kryesisht përmes mediave të Serbisë dhe mediave të vogla serbe të Kosovës, në të cilat partitë e tjera politike nuk kishin, ose kishin qasje shumë të kufizuara. Bashkëbiseduesit shpesh raportuan se anëtarët e LS-së u bënë presion votuesve të cilët varen shumë nga ndihma sociale e Serbisë ose punësimi në institucionet e menaxhuara nga Serbia në komunat serbe të Kosovës. Për më tepër, presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq e mbështeti haptazi LS-në dhe u bëri thirrje votuesve të votojnë për këtë parti. Më 3 shkurt, drejtori i Zyrës për Kosovë dhe Metohi njoftoi se do të shpërndahen 22,000 dinarë serbë (170 €) në muaj për personat në gjendje të vështirë sociale dhe të papunë, duke filluar me 5,000 përfitues që do i marrin kah mesi i shkurtit.

Vëzhguesit e EU EOM-së raportuan se subjektet politike joshumicë zhvilluan tubime të vogla dhe fushata derë më derë brenda komuniteteve të tyre. Mesazhet e fushatës u fokusuan në çështje të cilësisë së jetës, pengesat gjuhësore në arsimin fillor për komunitetin boshnjak, regjistrimin në shkollë për vajzat rome, si dhe politikat e qeverisë ndaj komuniteteve jo-shumicë.

Financimi publik është i disponueshëm për subjektet politike të përfaqësuara në kuvend. Megjithatë, për shkak të kundërshtimit të anëtarëve të KQZ-së të emëruar nga LVV-ja për shpërndarjen e fondeve për muajin janar dhe shkurt, garuesit i zhvilluan fushatat e tyre pa këto fonde. Ligji përfshin një dispozitë jo të detyrueshme për alokimin e fondeve publike shtesë për aktivitetet e fushatës për të gjitha subjektet politike të certifikuara. Kjo dispozitë nuk u zbatua, duke krijuar një terren të pabarabartë mes garuesve, veçanërisht për subjektet e vogla politike nga komunitetet jo-shumicë.

Keqpërdorimi i resurseve publike nga shumë garues u raportua nga vëzhguesit dhe bashkëbiseduesit e EU EOM në nivel qendror dhe komunal. Gjatë gjithë fushatës, “Zyra” në kuadër të KQZ-së nuk monitoroi aktivitetet e fushatës në mënyrë sistematike në të gjitha komunat për shkak të sfidave të rekrutimit. Monitoruesit ose u rekrutuan vetëm për gjysmën e periudhës së fushatës ose nuk u rekrutuan fare, gjë që rezultoi me mbetjen e një pjesë të konsiderueshme të fushatës zgjedhore pa u monitoruar.

## **KONTESTET ZGJEDHORE**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) është organ i përhershëm i pavarur prej 11 anëtarësh të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që aktualisht funksionon me dhjetë gjyqtarë në bazë të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, të rishikuar në vitin 2024. PZAP është forumi kryesor për gjykimin e kontesteve lidhur me zgjedhjet, përfshirë ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së të parashikuara në mënyrë specifike nga LZP. Në këtë kontekst, PZAP ka hedhur poshtë rastet që ishin jashtë kompetencave të tij dhe deri më tani ka referuar 18 raste në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), që është përgjegjës për gjykimin e ankesave

kundër mediave. Vendimet e PZAP-së mund të ankimohen në Gjykatën Supreme (GJS) në rast se gjoba është më e lartë se 5,000 euro ose nëse preken të drejtat themelore.

Që nga fillimi i procesit, PZAP ka pranuar mbi 500 raste. Ankesa kundër vendimeve të KQZ-së lidhur me hapjen e qendrave të votimit jashtë Kosovës janë paraqitur nga LVV dhe janë hedhur poshtë. Një ankesë kishte të bënte me certifikimin e subjekteve politike. PZAP e lejoi ankesën e LS kundër njoftimit të KQZ-së për refuzimin e certifikimit të saj, duke vendosur në favor të ankuesit. Certifikimi i më pastajmë i LS-së çoi në një ankesë tjetër nga LVV për mosrespektim të procesit të rregullt të vendimmarrjes së KQZ-së, e cila u hodh poshtë nga GJS për mungesë të bazës juridike. Katër ankesa lidhur me mos-shpërndarjen e fondeve publike nga KQZ-ja u refuzuan për mungesë të kompetencës. Ankesat tjera të parashtruara nga subjektet politike të komuniteteve joshumicë kanë të bëjnë me emërimin e stafit të votimit dhe numërimin, ku PZAP udhëzon KQZ-në që të rishqyrtojë formulën e përfaqësimit të aplikuar sipas kriteve të përcaktuara me ligj.

Rreth 400 ankesa janë parashtruar në PZAP për shkelje të kodit të mirësjelljes gjatë fushatës që kanë rezultuar me gjoba substanciale të shqiptuara ndaj subjekteve politike, veçanërisht për shkelje të përsëritura, në vlerë totale prej rreth €640,000.<sup>2</sup> Shkeljet kryesisht kishin të bënin me vendosjen e materialit të fushatës në vende publike, nxitjen e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes, keqpërdorimin e funksioneve dhe resurseve publike dhe shfrytëzimin e fëmijëve në fushatë. Shumica e rasteve janë paraqitur nga LVV, e ndjekur nga PDK dhe LDK, ndërsa shumica janë paraqitur kundër LVV-së, LDK-së dhe PDK-së. Përkundër vëllimit të rasteve dhe sfidave me resurse, PZAP-ja deri më tani duket se është duke performuar në mënyrë profesionale me vendime të arsyetuara mjaftueshëm dhe të publikuara me kohë. Ligji përcakton afate të qarta kohore dhe hapa të artikuluar mirë për shqyrtimin e kontesteve zgjedhore. Sidoqoftë, ai do të mund të përfitonte nga qartësia e mëtejshme, veçanërisht në lidhje me kriteret për përcaktimin e shumës së gjobave të shqiptuara dhe zgjerimin e të drejtës së ankimit. GJS deri më tani ka marrë 37 ankesa kundër vendimeve të PZAP-së. Prej 32 vendimeve të publikuara deri më tani, 22 janë hedhur poshtë dhe 10 janë aprovuar, duke kthyer mbrapsht vendimin e PZAP-së ose janë aprovuar pjesërisht, duke ulur gjobat e shqiptuara në shkallën e parë.

## **MEDIAT**

Kushtetuta dhe ligjet për media garantojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias. Mjedisi mediatik është dinamik por i fragmentuar, i formësuar nga ndarjet etnike dhe sfidat institucionale. Shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera jo-shumicë kryesisht jetojnë në sfera të ndryshme informacioni, të ndara nga një hendek gjuhësor që shumë pak media përpiqen ta kapërcejnë.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), përgjegjës për rregullimin dhe sanksionimin e mediave transmetuese, u bllokua për shkak të mungesës së kuorumit rreth tri javë para ditës së zgjedhjeve, duke mos mundur të sanksionojë 100 shkelje të mundshme të mediave dhe duke i lënë mediat në një paqartësi të zgjatur mes akuzave për ndikim politik. Transmetuesi publik RTK i përmbushi obligimet e tij ligjore dhe u ofroi të gjitha partive politike qasje të barabartë në kohë transmetimi falas dhe të sponsorizuar, pavarësisht sfidave siç janë bordi jofunksional dhe financimi i pamjaftueshëm.

Mbulimi i fushatës në mediat transmetuese u njollos nga shpifjet partiake, të cilat u përhapën në mediat online dhe rrjetet sociale. LVV bojkotoi tri media të njohura private, duke përmendur

---

<sup>2</sup> Subjektet politike që morën më së shumti gjoba: LVV, PDK dhe LDK, ndjekur nga AAK-NISMA, LS dhe Koalicioni për Familjen



mbulimin e vazhdueshëm negativ të partisë dhe qeverisë. Kjo në kombinim me debatet e planifikuara që, për shkak të mungesës, shpesh përfshinin vetëm përfaqësues të një partie, kufizoi mundësinë e votuesve për të krahasuar drejtpërdrejt kandidatët kryesorë dhe për të bërë një zgjedhje të informuar. Pati njëfarë analize të pavarur gazetareske mbi politikën e kandidatëve, veçanërisht në emisionin “*Debat Përnime*” të Dukagjinit, ku premtimet elektorale u sfiduan me të dhëna në kohë reale dhe verifikim faktesh. Partia në pushtet mori pjesë vetëm në shtatë nga 18 debatet në kanalet televizive të monitoruara, dhe partitë opozitare i dhanë prioritet kritikimit të qeverisë në vend të diskutimeve përmbajtësore të fokusuar në politika. Për fat të keq nuk u organizua asnjë debat ndërmjet kandidatëve kryesorë.

LZP-ja detyron të gjitha mediat të ofrojnë mbulim të drejtë dhe të barabartë për subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore, të cilën jo të gjitha partitë vendosën ta shfrytëzojnë. Ligji përcakton kufizime për kohën e transmetimit me pagesë dhe garanton një sasi minimale të kohës së transmetimit falas për të gjithë garuesit, të cilën jo të gjitha partitë vendosën ta shfrytëzojnë.<sup>3</sup> RTK1 ofroi mbulim të barabartë në lajme për subjektet kryesore politike, LVV, PDK, LDK dhe AAK-NISMA. Kanalet televizive private po ashtu u përpoqën të ofronin kohë të balancuar transmetimi për të gjitha partitë dhe kandidatët.

Komuniteti serb i Kosovës kryesisht mbështetet në mediat transmetuese nga Serbia për lajme. Edhe pse transmetuesi publik RTK2 është i disponueshëm në të dhjetë komunat me shumicë serbe anëmbanë Kosovës dhe organizoi debate, shikueshmëria e tij e kufizuar i lë partitë opozitare joshumicë pa një kanal televiziv publik efektiv, duke lënë hapësirë minimale për fushatë, përveç mediave sociale. LS refuzoi të marrë pjesë në ndonjë debat të organizuar nga RTK2. Shumica e mediave online në gjuhën serbe e mbuluan fushatën, megjithatë TV Most dhe Kosovo Online u fokusuan pothuajse krejtësisht në aktivitetet e LS.

## MEDIAT SOCIALE

Shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë vlerësohet të jetë mbi 95 përqind dhe rreth gjysma e popullsisë është e pranishme në platformat e mediave sociale. Facebook-u dhe Instagram-i janë platformat më të popullarizuara, me mbi 700,000 përdorues secila. TikTok është e treta, me një numër gjithnjë e më të madh përdoruesish, duke tejkaluar 500,000. Mediat sociale mbeten të parregulluara dhe platformat funksionojnë kryesisht sipas politikave dhe mekanizmave të tyre rregullues. Megjithatë, përmbajtja si gjuha e urrejtjes ose nxitja e dhunës bie nën juridiksionin e kodit penal dhe ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike.

Të gjitha partitë politike që garojnë në zgjedhje dhe mbi gjysma e kandidatëve ishin të pranishëm dhe bënë fushatë në mediat sociale me intensitet të ndryshëm, kryesisht në Facebook dhe Instagram. Mediat sociale në përgjithësi pasqyrojnë fushatat tradicionale të partive, me pak përmbajtje të zhvilluar posaçërisht për këtë medium. Gjysma e parë e fushatës ishte relativisht e qetë, me shumicën dërmuese të përmbajtjes së postuar nga partitë politike dhe kandidatët të përbërë nga fotografi dhe video nga ngjarjet e fushatës, të cilat sollën në platformat online një pjesë të retorikës së ashpër të garuesve. Kur partitë politike filluan të publikonin programet e tyre kah mesi i fushatës, u shtua edhe aktiviteti në mediat sociale.

---

<sup>3</sup> Njësia e monitorimit të mediave e EU EOM monitoroi pesë kanale televizive: RTK1 (publik), Dukagjini (privat), Klan Kosova (privat), T7 (privat) dhe ATV (privat) në transmetimin në orarin kryesor të mbërmjes prej orës 18:00–24:00.

Reklamat në Facebook dhe Instagram u përdorën gjerësisht nga partitë politike, nga shumë kandidatë dhe nga disa faqe të mbështetësve dhe mediave. Mbi €250,000 u shpenzuan për promovimin e më shumë se 7,000 reklamave lidhur me zgjedhjet në Facebook dhe Instagram, duke përfshirë reklama negative nga palët e treta. Që nga fillimi i janarit, RT Balkan dhe *Sputnik Srbija* të mbështetura nga Rusia kanë publikuar rreth 60 artikuj për zgjedhjet, disa me narrativa që pretendonin për manipulime kundër komunitetit serb. Shtrirja e tyre në mediat sociale është e kufizuar nga fakti se ato janë të pranishme vetëm në X, dhe postimet e tyre rrallëherë arrijnë të kenë më shumë se 2,000 përdorues.

## **PJESËMARRJA E GRAVE**

Ligjet e Kosovës që rregullojnë përfaqësimin politik të grave kanë nevojë për harmonizim të mëtejshëm. Barazia gjinore është e mishëruar në Kushtetutë, LZP (2023) dhe Ligjin për Barazinë Gjinore (2015). LZP kërkon që listat e partive për zgjedhjet parlamentare të përfshijnë të paktën 30 përqind të gjinisë më pak të përfaqësuar, ndërsa Ligji për Barazinë Gjinore përcakton një kuotë gjinore prej 50 përqind për të gjitha institucionet e zgjedhura. Një vendim i fundit i Gjykatës Kushtetuese deklaroi se neni 28 i LZP-së për kuotat gjinore është në përputhje me Kushtetutën, duke përcaktuar kuotën e tij si një prag minimal. Në zgjedhjet e vitit 2025 garuan 443 gra, duke përbërë 34.64 përqind të 1,279 kandidatëve të certifikuar. Ndonëse kjo është në përputhje me kuotën gjinore prej 30 përqind, ajo paraqet vetëm një rritje të papërfillshme në krahasim me zgjedhjet e mëparshme parlamentare. KQZ-ja nuk publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë për regjistrimin e votuesve dhe kandidatëve.

Derisa garueset [gra] nga subjektet kryesore politike nganjëherë përbënin titujt e ngjarjeve të fushatës, burrat kishin një prani dominuese në mitingje, duke përbërë një shumicë të konsiderueshme të pjesëmarrësve dhe folësve. Rreth 28 përqind e pjesëmarrësve në 75 mitingjet e vëzhguara ishin gra. Diskursi politik, veçanërisht në platformat e mediave sociale, ishte shpesh armiqësor ndaj grave kandidatë që kritikoheshin për pamjen ose statusin e tyre martesor. Gratë kandidatë kishin më pak burime se homologët e tyre meshkuj, më pak mbulim mediatik dhe u shfaqën në më pak debate televizive. Sipas monitorimit të EU EOM-së, gratë u paraqitën 15 përqind të kohës në orarin kryesor në pesë kanale televizive prej 11 janarit deri më 8 shkurt.

LZP-ja po ashtu ofron një stimulim financiar për të rritur përfaqësimin e grave duke dedikuar një fond shtesë prej një përqind të shumës së fondeve publike të alokuar për subjektin politik për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën. Megjithëse LZP përfshin dispozita që inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në administratën zgjedhore, ato dispozita nuk janë të detyrueshme. Vetëm dy nga 11 anëtarët e KQZ-së janë gra. Gratë po ashtu përbënin 23 përqind të anëtarëve të KKZ-ve, duke përfshirë 16 përqind të kryesuesve, ndërsa EU EOM vërejti se 28.3 përqind e anëtarëve të KVV-ve në qendrat e vizituara të votimit ishin gra.

## **PJESËMARRJA E KOMUNITETEVE JOSHUMICË**

Kushtetuta e përkufizon Kosovën si një shoqëri shumetnike duke vënë theks të konsiderueshëm në të drejtat e komuniteteve joshumicë, veçanërisht duke garantuar 20 ulëse në Kuvend. Në aspektin pozitiv, 20 nga 28 listat e certifikuara përfaqësojnë komunitetet joshumicë dhe katër anëtarë të komuniteteve joshumicë kanë shërbyer në Qeverinë në largim. Përveç serbëve të Kosovës, bashkëbiseduesit nga subjektet politike jo-shumicë treguan se ata ishin në gjendje t'i zhvillonin fushatat e tyre pa ndërhyrje nga autoritetet. Po kështu, ata nuk regjistruan asnjë rast ngacmimi në internet ose gjuhe diskriminuese drejtuar komuniteteve të tyre. Përderisa raportuan për marrëdhënie të mira me KQZ-në dhe KKZ-të, disa parti ishin kritike ndaj përbërjes së KVV-ve, të cilat ata i konsideruan me përfaqësim të pamjaftueshëm. Fushata ndërjegjësuere e KQZ-së për procedurat e votimit në gjuhën turke, boshnjake dhe rome po ashtu u zhvillua me vonesë. Në një shkëputje nga

praktikat e kaluara, dizajni i fletëvotimit përfshinte gjuhën shqipe dhe serbe në krye duke lënë jashtë gjuhën turke.

## VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Ndonëse legjislacioni zgjedhor parashikon vëzhgimin e të gjithë procesit zgjedhor, KQZ e kufizoi periudhën e regjistrimit për akreditim në muajin e fundit para zgjedhjeve, gjë që shkaktoi mospërputhje me afatet e shumë fazave të rëndësishme të procesit zgjedhor. Pozitivisht, akreditimi zyrtar u kërkua *de facto* nga administrata zgjedhore vetëm për qasje në ambientet zgjedhore ditën e zgjedhjeve, dhe vëzhguesit nuk raportuan asnjë pengesë në punën e tyre. Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ akreditoi 22 organizata vendase, përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit, me gjithsej 1,193 vëzhgues si dhe rreth 18,600 vëzhgues partiakë. Përpjekja më e madhe për vëzhgim nga shoqëria civile u udhëhoq nga koalicioni i vëzhguesve Demokracia në Veprim, i cili shpërndau vëzhgues afatgjatë për të monitoruar fushatën zgjedhore dhe ambientin parazgjedhor.

## VOTIMI DHE NUMËRIMI

Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe në përgjithësi votimi u zhvillua pa probleme, megjithëse vëzhguesit dhe mediat raportuan incidente të izoluara brenda dhe përreth qendrave të votimit. Ndërsa votimi në përgjithësi u vlerësua pozitivisht, me disa gabime procedurale, vështirësitë në zbatimin e procedurave u bënë më të dukshme gjatë fazës së numërimit. Vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm në 97 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, ndërsa vëzhguesit nga radhët e qytetarëve u raportuan në 23 përqind të tyre. Gratë përbënin 28 përqind të stafit zgjedhor, përfshirë 23 përqind të kryetarëve të komisioneve. Në mëngjesin e ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja njoftoi vendimin e saj, të miratuar më 8 shkurt, për të lejuar përdorimin e dokumenteve të skaduara të identifikimit për votuesit.

Hapja e vendvotimeve u vlerësua pozitivisht në 40 nga 43 vendvotimet e vëzhguara nga vëzhguesit e BE-së. Shumica e vendvotimeve të vëzhguara u hapën në kohë, dhe vetëm disa patën vonesa të vogla nën 30 minuta për shkak të mungesës së organizimit ose të kuptuarit të pamjaftueshëm të procedurave nga anëtarët e KVV-ve. Derisa procedurat kryesisht u respektuan, u vunë re disa lëshime procedurale, duke anashkaluar masa të rëndësishme të integritetit, siç është regjistrimi i materialeve zgjedhore të ndjeshme. Qendrat e votimit me kusht raportuan për vështirësi në qasjen në platformën e regjistrimit online, duke rezultuar në hapjen me vonesë dhe zgjatjen e kohës së pritjes për votuesit.

Vëzhguesit vlerësuan procesin e votimit si të organizuar mirë dhe transparent në 97 përqind të 412 vendvotimeve të vizituara. Procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, megjithëse mungesa e trajnimit të stafit zgjedhor u evidentuan nga një numër gabimesh procedurale. Si masë shtesë sigurie, u përdor ngjyra e pashlyeshme për të shënjuar votuesit për të parandaluar votimin e shumëfishtë. Megjithatë, vëzhguesit e BE-së vunë re se gishtat e votuesve nuk u kontrolluan në mënyrë të vazhdueshme për gjurmë të ngjyrës në 15 përqind të rasteve të vëzhguara. Për më tepër, vëzhguesit e BE-së raportuan se shënimi me ngjyrë në gishta mund të hiqej. Për shkak të udhëzimeve të vonuara për përdorimin e dokumenteve të skaduara, në disa raste disa votues nuk u lejuan të votonin.

Fshehtësia e votës u komprometua në 5 përqind të vendvotimeve të vëzhguara për shkak të strukturës së vendvotimit, pozicionimit të kabinave të votimit dhe njerëzve që qëndronin shumë afër tyre, si dhe në 17 përqind të vendvotimeve për shkak të pozicionimit të kamerave. Vëzhguesit e BE-së raportuan raste të votimit në grup në 4 përqind të vendvotimeve të vëzhguara. Në 11

përqind të vendvotimeve u raportua për materiale të pamjaftueshme ose që mungonin, përfshirë formularët e ankesave, mungesën e fletëvotimeve për votim me kusht dhe lista të kandidatëve. Posterët me udhëzimet për votim nuk u shfaqën në 19 përqind të vendvotimeve. Përveç kësaj, informacioni ishte i disponueshëm kryesisht në gjuhën shqipe.

Procedurat e reja për votimin me asistencë nuk u zbatuan në mënyrë konsistente në 64 përqind të vendvotimeve të vëzhguara, ku shpesh këshillat e vendvotimeve (KVV) lejuan votuesit të asistoheshin pa dokumentacionin e kërkuar ose pa regjistruar arsyen për asistencë. Rreth 38 përqind e qendrave të votimit nuk ofronin qasje të pavarur për personat me aftësi të kufizuara të lëvizjes dhe 17 përqind e qendrave të votimit kishin strukturë të papërshtatshme për këta votues. KVV-të nuk kishin marrë ose nuk ishin në dijeni për praninë e shablloneve në Braille për fletëvotimet për votuesit me shikim të dëmtuar në 45 përqind të vendvotimeve të vëzhguara.

Vëzhguesit e BE-së e vlerësuan negativisht procesin e mbylljes dhe numërimit në 8 nga 42 vendvotimet e vëzhguara për shkak të gabimeve procedurale, megjithëse në përgjithësi ai u vlerësua si transparent. Kontrollat e parapara të integritetit, si numërimi dhe paketimi i materialeve të përdorura dhe materialeve të tjera të ndjeshme, nuk u përfunduan siç duhet në afër dy të tretat e vëzhgimeve para fillimit të numërimit. Procedurat e numërimit nuk u kryen sipas radhës së përcaktuar në më shumë se një të katërtën e rasteve, ose u kryen në mënyrë të njëkohshme, duke ndikuar negativisht në transparencë. Gjatë numërimit, vlefshmëria e fletëvotimeve nuk u përcaktua në mënyrë konsistente ose në përputhje me rregullat e përcaktuara në katër raste, dhe një përcaktim i tillë u kundërshtua nga disa anëtarë të KVV-së në gjashtë raste. Vëzhguesit e BE-së raportuan nga tetë numërime se anëtarët e KVV-ve kishin vështirësi në plotësimin e formularëve të rezultateve për shkak se nuk i kuptonin mjaftueshëm procedurat ose nuk i kishin respektuar ato siç duhet. Në shtatë vendvotime, KVV-të nuk i ekspozuan publikisht kopjet e formularëve të rezultateve siç kërkohet me ligj.

Natën e zgjedhjeve, sistemet e TI-së të KQZ-së nuk ishin të disponueshme për një periudhë të gjatë, duke ndikuar në publikimin e rezultateve preliminare dhe në pranimin e materialeve zgjedhore në qendrat komunale të numërimit. Për të kapërcyer këto vështirësi, KKZ-të dhe KQZ-ja u detyruan që së pari t'i përpunojnë të dhënat në mënyrë manuale. Vëzhguesit e BE-së e vlerësuan këtë fazë si transparente dhe efikase, përkundër sfidave teknike.

Numërimi i votave preferenciale, fillimisht i planifikuar për mëngjesin e 10 shkurtit, u shty për shkak të problemeve të vazhdueshme teknike dhe raportimeve për mungesë të pajisjeve dhe softuerit kritik. Një fazë tjetër e rëndësishme e procesit, përfshirë numërimin e votave prej jashtë Kosovës dhe atyre me kusht, si dhe fletëvotimet e hedhura në kutitë mobile, ende nuk kishte filluar në kohën kur po shkruajmë.

---

Një version elektronik i kësaj deklarate preliminare është e disponueshme në faqen e internetit të EOM: [eeas.europa.eu/eom-kosovo-2025](https://eeas.europa.eu/eom-kosovo-2025). Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni: Emilia Hinkkanen, Zyrtares për Media e EU EOM, tel.: +383(0)45 536 911, email: [emilia.hinkkanen@eueomkosovo2025.eu](mailto:emilia.hinkkanen@eueomkosovo2025.eu).

**Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian**  
*Hoteli Swiss Diamond, Bulevardi Nënë Tereza P.N. - 10000 Prishtinë, Kosovë*

---